



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli Geci Shp.k / Albanian Consortium Sh.a/ Sky 2009 Sh.a

Në datën 20 Janar 2012, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të marrëveshjes mbi bashkimin me përthithje të shoqërive Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a nga shoqëria Geci Sh.p.k, më datë 13 Dhjetor 2011, me objekt përfitim e kontrollit të vetëm në shoqëritë e përthithura Albanian Consortium Sh.a dhe Sky 2009 Sh.a.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Për **Geci Sh.p.k**: kryen veprimtari në fushë ndërtimit, kryesisht në infrastrukturën rrugore, ndërtimit të rrugëve kryesore , autostrada, superstrada, ura, ujësjellësa e kanalizime, ndërtime civile dhe industriale si shkolla , ndërtesa etj.;
- Për **Albanian Consortium Sh.a**: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e hotelerisë dhe turizmit nën emrin Tirana International Hotel & Conference Center. Tirana International Hotel & Conference Center vepron si një njesi akomoduese hotelerie dhe si qendër për organizimin e eventeve dhe konferencave e certifikuar me 4 Yje;
- Për **Sky 2009 Sh.a**: ushtron veprimtarinë e saj në fushën e hotelerisë dhe turizmit si dhe të aktivitetit të pjesëmarrjes në kapital.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja a) dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al